REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 2023/0052
Datë/Datum. 20/02/2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
Florije Rexhepi	**03.02.2023**	**15.02.2023**	**2023/0052**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me daten: 27.01.2023, OE "DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K."- Prishtine, ka parashtruar ankese me nr: 2023/0052, kunder njoftimit per kontrate, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "RITENDER -Sherbimet e DDD per te gjitha hapesirat e brendshme dhe jashtme te QKUK-se" me nr. te prokurimit: "701-22-14388-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 94,973.30 €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:

Data e njoftimit për kontratë.....16.12.2022

Hapja e ofertave..... 06.01.2023

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara.....29.12.2022

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara…….06.01.2023

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara…….18.01.2023

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara…… 24.01.2023

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 5 pika 1.1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 9 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 13 par.4 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 27 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional:

Kërkesa 2.Operatori Ekonomik duhet te jete i certifikuar me standarde ISO&OHSAS.

Kërkesa 3.Operatori Ekonomik duhet te jet i certifikuar me ISO 9001-2015 - Menaxhimi i Cilësisë për shërbimet e DDD.

Kërkesa 4.Operatori Ekonomik duhet te jet i certifikuar me ISO 14001-2015 - Sistemi i Menaxhimit të mjedisit për shërbimet e DDD.

Kërkesa 5.Operatori Ekonomik duhet te jete i certifikuar me OHSAS 45001-2015 - Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë për shërbimet e DDD.

Kërkesa 6. OE duhet te ofroj akreditimin e organizatës apo kompanisë qe ka lëshuar certifikimet ISOKërkesa 7.Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt,(min. 10 punëtorë) Në kuadër te stafit profesional duhet te ketë a)Së paku një (1) Epidemiolog. b)Dy (2) Inxhinier sanitar, c) Një (1) Biolog d)Një (1) Ekolog, e) Pesë(5) punëtorë te certifikuar për kryerjen e shërbimit DDD, f. Dy (2) Teknik të Certifikuar Integrated Pest Management (IPM) g. Dy (2) teknik te Certifikuar Advanced Pest

Kërkesa 8. OE duhet te dëshmon se posedon mjete, stabilimentet ose pajisjet teknike qe ka ne dispozicionin për realizimin e shërbimeve te DDD-së. Pajisjet minimale për ketë projekt kërkohen a) se paku 5 pompa ULV elektrike. b) 1 ULV aersol të vendosur në automjet për dezinfektim në hapësira të jashtëm c) 5 pajisje për pastrimin e ajrit brenda objektit qe largon grimca pm2.5 dhe pm10 si dhe largimin e viruseve d) se paku 4 automjete për kryerjen e shërbimeve

Kërkesa 9.Përshkrimi i mënyrës së implementimit të shërbimeve Dezinsektim ,Dezinfektim dhe Deratizim të brendshëm dhe të jashtëm.

Kërkesa 10.Leja për importin e produkteve Biocide nga autoritetet relevante.

Kërkesa 11. Listën e preparateve

Kërkesa 12. Afati i përfundimit te shërbimeve 21 ditë kalendarike nga marrja e urdhëresës .

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Evidenca 1. Kopja e noterizuar e licencës valide e lëshuar nga MBPZHR për kryerjen e punëve profesionale të DDD.

Evidenca 2.Kopja e akreditimit në versionin shqip dhe anglisht të organizatës e cila e ka lëshuar certifikatat për OE.

Evidenca 3.Kopja e noterizuar e certifikatës ISO 9001-2015 - Menaxhimi i Cilësisë për shërbimet e DDD.

Evidenca 4.Kopja e noterizuar e certifikatës ISO 14001-2015 - Sistemi i Menaxhimit të mjedisit për shërbimet e DDD.

Evidenca 5.Kopja e noterizuar e certifikatës OHSAS 45001-2015 - Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë për shërbimet e DDD.

Evidenca 6. Kopja e Akreditimit

Evidenca 7.Një pasqyrë tabelare e personelit të angazhuar, duhet të dorëzohet në origjinal i nënshkruar dhe i vulosur nga ATK-ja. Për piken a) duhet të dëshmojë me një diplomë universitare të noterizuar, licencën profesionale mjekësore të vlefshme, CV-ja. Për piken b)Te dëshmohet me një diplomë të noterizuar, një licencë për ushtrimin e veprimtaris profesionale. Për pikën c). Të dëshmohet me diplomë te noterizuar , certifikatë laboratorike, CV-ja. Për pikën d). Të dëshmohet me diplomë universitare e noterizuar, CV-ja. Për pikën e). Dëshmitë e diplomave ose certifikatave të trajnimit. Për pikë f). Të dëshmohet me certifikata të trajnimit (e noterizuar) Për pikën g. Të dëshmohet me certifikata të trajnimit (e noterizuar)

Evidenca 8.Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike qe janë në dispozicionin tuaj për te ekzekutuar kontratën në fjalë- pajisjet dhe makineria në dispozicion duhet të kenë certifikime ISO për cilësi dhe të dëshmohen me kopje të librezave mbi pronësi e tyre ose DUD doganore dhe fatura e blerjes ose kontrata mbi qiramarrjen të noterizuar. Për automjete te kërkohet dëshmi librezat valide.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

N/A

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

Është kualifikuar si pale konform Nenit 4.1.26 të LPP-së

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K." - PRISHTINË

Pretendimi Nr. 1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, ne ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me kërkesat e vendosura ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontrate, për te cilat i njëjti ka kërkuar sqarime gjatës fazës se kritereve. Lidhur me kërkesat për të cilat ka kërkuar sqarime, ka marr përgjigje negative dhe i njëjti parashtron ankese ne OSHP, me pretendimin se kërkesat janë favorizuese dhe diskriminuese për OE-te të cilët shprehin interes për ketë aktivitet te prokurimit.

Ne vazhdim eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues pretendon se, AK-ja, ka kërkuar me dosje te tenderit qe OE-te duhet te ofrojnë 2 inspektor sanitar dhe sipas pretendimit te OE ankues fakti që janë kërkuar dy inspektore sanitar përbën konflikt interesi sepse të njëjtën pune e realizojnë inspektorati sanitar i Republikës se Kosovës si institucion i pavarur.

Lidhur me ketë pretendim AK, ka dhëne këtë përgjigje:

Sqarim: Inspektorët/Ing sanitar janë profesionist që fokusohen në preventimin, konsulktimin, hulumtimin dhe edukimin e komunitetit për rreziqët e shëndetetit nga ambienti si dhe mirren me sigurimin e një ambienti "health friendly". Ne e kemi parë të nevojshme që të tillët të jenë në ekipë për DDD për hulumtimine dhe detektimin e ndotjeve sidomos të mjeteve sanitarë në QKUK, vlerësimin e tyre dhe mbikqyrejn e pastrimit sipas specifikave që ata njohin.

Eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim i OE ankues qëndron për faktin se autoriteti kontraktues mund të angazhoje inspektoratin sanitar që të bëjë inspektime, hulumtime dhe edukimin e komunitetit për rreziqet e shëndetit, kompetenca këto të cilat i ushtron inspektorati sanitar në Republikën e Kosovës dhe njëherit duke u bazuar në sqarimin e cituar me larte, eksperti shqyrtues, vlerëson se në ketë rast puna e dy inspektoreve nuk ka të bëjnë me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Prandaj, kërkesa për dy inspektore duhet të hiqet në tërësi nga dosja e tenderit.

Pretendimi Nr. 2.

OE ankues në ankesën e tij pretendon se edhe kërkesa për 1 Biolog e vendosur tek kërkesa nr. 7 pika C, është kërkesë diskriminuese dhe favorizuese.

Lidhur me ketë pretendim AK, ka dhënë ketë përgjigje:

Sqarim: Biologu njeh mikroorganizmat e deri te gjallesat më të mëdha, gjithashtu edhe botanikën dhe mund të vlerësoje ndërhyrjet në procesin e DDD-së duke tentuar të ruaj në përgjithësi, në bashkëpunim me Ekologun dhe Epidemiologun ekosistemin e padëmshëm. Gjithashtu biologu I laboratorit është në gjendje, ne rast kur shihet e arsyeshme nga OE për të marrë mostra ku shihet e nevojshme dhe për të vendosur nëse procesi I DDD-së duhet të shtyhet tutje, aty ku shieht e nevojshme. Ekuivalentet e një roli të tillë janë të mirëseardhur.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në sqarimin e dhëne nga AK-ja, fillimisht vlerëson se sqarimi është i mangët sepse AK-ja deklaron se "Biologu i laboratorit është në gjendje për të marrë mostra..." se për çfarë mostra është fjala nuk e ka sqaruar dhe njëherit mostrat testohen në laborator të cilat AK-ja nuk e ka i ka parapare në përshkrim të çmimit – paramasë. Prandaj, ky pretendim i OE ankues qëndron dhe se kjo kërkesë duhet të hiqet si kërkesë e dosjes së tenderit sepse natyra e punës së biologut nuk ka të bëjë me natyrën e aktivitetit të prokurimit.

Pretendimi Nr. 3.

Ne vazhdim eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues po ashtu pretendon se kërkesa për 1 Ekolog është kërkesë

diskriminuese dhe se nuk ka të bëje me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me ketë pretendim AK, ka dhënë ketë përgjigje:

Sqarim: Ekologu vlerëson ekosistemin dhe duhet të ndërmerr strategjinë e nevojshme për të shkaktuar sa më pak dëmë në ambientin e jashtëm. Një shqetësim I tillë është ngritur edhe në qarqet ndërkombëtare cka është parë e nevojshme që në ndërmarrjet e DDD-së, sidomos kur kemi të bëjmë me intervenimet jashtë, të kemi një ekolog/ambientalist.

Eksperti shqyrtues vlerëson se kjo kërkesë duhet të hiqet nga kërkesat e dosjes së tenderit, për faktin se me një kërkim të thjeshte, si shkence Ekologjia cilësohet edhe si shkencë e cila merret me studimin e strukturës dhe funksionimin e biosferës. - Ekologjia e bimëve merret me studimin e marrëdhënieve dhe veprimeve të cilat ndodhin në botën bimore ***(fitocenoza)***. Në anën tjetër ekologjia e shtazëve merret me studimin e marrëdhënieve midis llojeve shtazore dhe bashkësive të tyre ***(zoocenozave)***. Ekologjia e mikroorganizmave është pak e studiuar.

Duke u bazuar në sqarimin e dhëne me larte kjo kërkesë nuk ka të bëje me natyrën e aktivitetit të prokurimit.

Pretendimi Nr. 4.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, pretendon se lidhur me kërkesën nr. 7, konkretisht te evidenca nr. 7 AK-ja, ka kërkuar: Një pasqyrë tabelare të personelit të angazhuar, duhet të dorëzohet në origjinal i nënshkruar dhe i vulosur nga ATK-ja.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se kërkesa e cituar me larte duhet të plotësohet në mënyrë që tu mundësohet OE-ve edhe prezantimi i stafit me kontrata mbi vepër sepse me plotësimin e kësaj kërkese AK-ja edhe obligohet që të veproj sipas dispozitave të nenit 26.4 të RRUOPP-se.

26.4 Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike.

Pretendimi nr. 5

OE ankues, në ankesën e tij lidhur me kërkesën nr. 8 ku AK-ja, te pika C, ka kërkuar: 5 pajisje për pastrimin e ajrit brenda objektit që largon grimca pm 2.5 dhe pm 10 si dhe largimin e viruseve.

Lidhur me ketë pretendim AK, ka dhënë ketë përgjigje:

Sqarim: Sërish vijmë tek pika e njëjtë, vlerësojme se është e nevojshme kaq numri shkaku I sipërfaqes së QKUK-së dhe moslërjen e rastësisë së ndodhjes së gabimeve, por të mbulohet cdo mm3 në QKUK.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se kërkesës për sqarim të kësaj kërkese të OE ankues, AK-ja nuk i ka dhënë përgjigje konkrete. Ndërsa në anën tjetër në ankesën e tij OE ankues e ka dhënë një kalkulim lidhur me sipërfaqen totale QKUK e cila do të dezinfektohet, deratizohet dhe dezinsektohet në raport me numrin e pajisjeve të cilat i ka kërkuar AK-ja, dhe në fund konstaton se është e pamundur të mbulohet sipërfaqja e QKUK-se, me këto pajisje.

Eksperti shqyrtues lidhur me ketë pretendim sqaron se, në ketë pretendim OE ankues nuk është deklaruar se a duhet të rritet numrin apo zvogëlohet numri i pajisjes, prandaj nuk qëndron pretendimi se është kriter favorizues.

Megjithatë eksperti shqyrtues vlerëson se me rastin e përmirësimit të kërkesave të mësipërme autoriteti kontraktues dhe operatori ekonomik duhet të sqarohen me në detaje lidhur me hapësirën dhe numrin e pajisjeve.

Pretendimi Nr.6.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, se AK-ja në kundërshtim me dispozitat e LPP-se, ka kërkuar dëshmit e pronësisë se mjeteve, duke pretenduar se kërkesa për librezat mbi pronësinë e mjeteve është absurditet dhe se kërkesa për ISO standarde OHSMS 45001-2018 nuk ekziston në Kosove, nuk qëndron.

Lidhur me ketë pretendim AK, ka dhënë ketë përgjigje:

SQARIM: Kërkesa për ndryshim të OHSAS 45001-2015 në OHSMS 45002-2018 është e arsyeshme dhe zëvendësohet duke ju përshtatur këkresave më të reja për menagjim të vendeve të punës nga rreziqët për lëndime ne vënd të punës dhe dëmtim të shëndetit.

Eksperti shqyrtues lidhur me ketë pretendim sqaron se kërkesa lidhur me dëshmitë e pronësisë nuk mund të konsiderohet absurditet, ndërsa kërkesa për Iso standardin e cituar me larte, eksperti shqyrtues pasi ka analizuar vlerëson se është ne përputhje me natyrën e aktivitetit të prokurimit.

ISO standarde OHSMS 45001-2018 - është një standard ndërkombëtar për shëndetin dhe sigurinë në punë i zhvilluar nga komitetet kombëtare dhe ndërkombëtare të standardeve të pavarura nga qeveria.

Pretendimi Nr.7

Në fund të pretendimeve të tij, OE ankues pretendon se autoriteti kontaktues e ka hequr sulfurin si repelent dhe njëherit e kundërshton arsyetimin e AK-se se institucioni relevant nuk e konsideron si substance biocide dhe nuk lëshon leje për një preparat të tille për shkak të demit të madh që shkakton.

Eksperti shqyrtues lidhur me ketë pretendim sqaron se qëndron ky pretendim i OE ankues, për faktin se i njëjti ka ofruar prova që lejohet importi i kësaj substance, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit hapësinor dhe Infrastrukturës të lëshuar me date 21.06.2022.

Eksperti shqyrtues si sqarim shtese i rekomandon AK-se që me rastin përmirësimit të kërkesave të dosjes së tenderit ti drejtohet ministrisë përkatëse lidhur me lejen e importit për verifikim.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues t? aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa njoftimi për kontrate të anulohet dhe të përmirësohen kërkesat e sqaruara më lartë dhe të veproj në harmoni me nenin 53 të LPP-së.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues – **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES** .

- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - **DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**

Florije Rexhepi